



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË



Nr. _____ Prot

Korçë, më ____ .08.2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Date 29.08.2024

Drejtuar: **Shoqërisë “FLED”sh.p.k** *adresa: Berat Kozare HAVALEHAS Lagjja" Havaleas", rruga Ura e kozares Kuçovë, godinë private 1- katëshe, Nr.307.8.*

Procedura e prokurimit: **Procedure e hapur e thjeshtuar**

Numri i procedurës **REF-13642-07-19-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës :

Objekti: **“Ndërtimi i pritave malore dhe mbrojtjeve lumore në njësitë administrative, Bashkia Korçë”**

Afati: **28 dite kalendarike**

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike : **Nr. 42, Date 29.07.2024, Nr 54 Date 26.08.2024.**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1.Shoqëria “NIKA ” shpk, NIPT J76705047U me vleren:

8.012.888,63 (tetë milion e dymbëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë presje gjashtëdhjetë e tre)lekë, pa tvsh.

2. Bashkimi i operatoreve „INFINIT“sh.p.k, NIPT J74304623M, “ J O G I” shpk, NIPT J63229478K dhe L.T.E CONSTRUCTION, NIPT L78006801F me vlerën:

8.973.191,8 (tetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e njëqind e nëntëdhjetë e një presje tetë)lekë,pa tvsh.

3. Shoqëria “FLED” shpk, NIPT K17621104C me vlerën:

9.086.595 (nëntë milion e tetëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë)lek,pa tvsh.

4. Shoqëria „AVDULI“ shpk, NIPT J66703306O me vlerën:

9.707.361 (nëntë milion e shtatëqind e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një)lekë,pa tvsh.

5. Shoqëria “ VILDEV - CO ” shpk, NIPT K83926001F me vlerën:

9.887.448 (nëntë milion e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e dyzet e tetë)lekë,pa tvsh.

6. Bashkimi i operatoreve “ GLAVENICA” shpk, NIPT K17710805A ” dhe “ NGRACAN 1934 ” shpk, NIPT J87602809S me vlerën:

9.916.630,5 (nëntë milion e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë presje pesë)lekë,pa tvsh.

7. Bashkimi i operatoreve “ XHENGO” shpk NIPT J64103171M, dhe “ CURRI ” shpk, NIPT J67902718S me vlerën:

9.969.099 (nëntë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëdhjetë e nëntë)lekë,pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Shoqëria “ NIKA ” shpk, NIPT J76705047U, per arsye se:

Komisioni i Vleresimit te Ofertave, mbas verifikimit të ofertave beri llogaritet per te percaktuar nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së percaktuar në dokumentet standarde të tenderit dhe ne nenin 82 pika 4 të VKM 285 date 19.05.2021”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik ku percaktohet se “Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;”

Mbas llogaritjeve te bera u konstatua se oferta juaj eshte me cmim anomalisht te ulet,ne keto kushte oferta refuzohet bazuar ne 93 pika 5 e Ligjit Nr. 162 dt. 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin Nr nr. 16/2024, datë 8.2.2024 ku percaktohet se:

“5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”

2. Bashkimi i operatoreve „INFINIT“sh.p.k, NIPT J74304623M, “ J O G I” shpk, NIPT J63229478K dhe L.T.E CONSTRUCTION, NIPT L78006801F per arsye se:

I.Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7,kriteret e vecanta të kualifikimit,pika 2.2.1 ku është përcaktuar shprehimisht se:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të vogël se 29 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës** që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se 99 % e vlerës të përlllogaritur të kontratës** që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten :

1. Formularin e vleresimit sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
2. Kontratë
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten

1. Kontrate;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Akt kolaudimi;
4. Fatura tatimore

Konkretisht: Ky kriter nuk permbushet nga shoqëria “Jogi” sh.p.k anetar i bashkimit të operatoreve i cili ka marre persiper te realizojë 40% të punimeve.

Shoqëria Jogi sh.p.k ka paraqitur nje kontrate të lidhur me Zyrën UNOPS në Shqipëri me objekt “Restaurim i ures Kurcaj”

Ofertuesi ka dorezuar kontraten dhe situacionin e cila eshte ne gjuhen angleze dhe mungon akti i kolaudimit cka bie në kundërshtim me përcaktimin e bere në:

- 1.** Kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7,kriteret e vecanta të kualifikimit,pika 2.2.1
- 2.Në dokumentat e tenderit,Njoftimi i kontrates ,pika 4.5 ku është përcaktuar shprehimisht:

4.5 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip

x

Anglisht

□

Gjithashtu ne shtojcen 7,pika 1 “Kriteret e pergjithshme te perzgjedhjes/kualifikimit eshte percaktuar se : “Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.”

3.Gjithashtu në nenin 88 pika 3 të VKM 285 datë 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” eshte percaktuar se : “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, **në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

Per sa më sipër ofertuesi skualifikohet per mospermbushje të kriterit lidhur e punet e ngjashme.

II. Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7,kriteret e vecanta të kualifikimit,pika 2.2.2 ku është përcaktuar shprehimisht se:

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë , e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Kategoria	Klasifikimi	Emertimi i kategorise
N.P. 1	A	Punime gërmimi në tokë
N.P - 9	A	Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.
N.S – 18	A	Punime topogjeodezike.

Konkretisht: Ky kriter nuk permbushet nga shoqëria “L.T.E CONSTRUCTION sh.p.k anetar i bashkimit të operatoreve i cili ka marre persiper te realizojë 30% të punimeve.

Shoqëria “L.T.E CONSTRUCTION sh.p.k nuk ka dorëzuar licence profesionale te shoqërise të leshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për punimet që ka marrë përsipër të realizoje sipas kontrates te bashkëpunimit.

3. Shoqeria „AVDULI“ shpk, NIPT J66703306O per arsye se:

Preventivi i paraqitur nga ofertuesi nuk perputhet me preventivin e shpallur nga autoriteti kontraktor.
Konkretisht : Në shtojcën 2 “Lista e cmimeve sipas zerave te preventivit” ,tek objekti **OBJEKTI 6 : Mbrojtje lumore fshati Marjan .NJ.Adm Lekas mungon zeri** “Gabiona me rrjete teli te zinguar e gure kave 1x1x1” Sasia 33

m3, cka është në kundërshtim me përcaktimin e bërë në këtë formular ku është përcaktuar shprehimisht se “Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivëve dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe të vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëratë pa ofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.”

4. Shoqëria “VILDEV - CO” shpk, NIPT K83926001F për arsye se:

I. Nuk plotëson kriterin e vendosur në dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.2.1 ku është përcaktuar shprehimisht se:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të vogël se 29 % e vlerës së përlogaritur të kontratës** që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se 99 % e vlerës të përlogaritur të kontratës** që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten :

5. Formularin e vleresimit sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
6. Kontratë
7. Situacionin përfundimtar;
8. Aktin e kolaudimit;

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten

5. Kontrate;
6. Situacionin përfundimtar;
7. Akt kolaudimi;
8. Fatura tatimore

Konkretisht: Për plotësimin e këtij kriteri ofertuesi ka paraqitur kontratat:

“Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara” lidhur ndërmjet Bashkisë Devoll dhe BOE “Vildev-Co dhe Alb Korca” sh.p.k.

Kjo kontratë nuk është e ngjashme me objektin e prokurimit.

Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara” lidhur ndërmjet Bashkisë Maliq dhe BOE “Vildev-Co dhe Alb Korca” sh.p.k.

Kjo kontratë nuk është e ngjashme me objektin e prokurimit.

Rikonstrukcion objekte shkollore+terrene lidhur ndërmjet Bashkisë Maliq dhe BOE “Vildev-Co dhe Alb Korca” sh.p.k.

Kjo kontratë nuk është e ngjashme me objektin e prokurimit.

“Meremete 2020” lidhur ndërmjet NSHMAC dhe BOE “Vildev-Co dhe Alb Korca” sh.p.k.

Kjo kontratë nuk është e ngjashme me objektin e prokurimit.

“Rikonstrukcion i shkollës 9-vjecare” Vithkuq e lidhur me Bashkinë Korçë është me vlerë 3.473.369 lek,me tvsh,

Kjo kontratë nuk është e ngjashme me objektin e prokurimit

Kontratat me objekt “Riparim ujitje ne forme shiu”dhe “Riparim sistem vaditje ne forme shiu njesia administrative Voskop”të lidhura me NSHP Korce,të cilat mund te konsiderohen te ngjashme me objektin e prokurimit nuk plotesojne vlerën e kërkuar ne dokument e tenderit per punet e ngjashme.

5. Bashkimi i operatoreve “ GLAVENICA” shpk, NIPT K17710805A ” dhe “ NGRACAN 1934 ” shpk, NIPT J87602809S per arsye se:

1.Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7,kriteret e vecanta të kualifikimit,pika 2.2.2 ku është përcaktuar shprehimisht se:

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë , e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Kategoria	Klasifikimi	Emertimi i kategorise
N.P. 1	A	Punime gërmimi në tokë
N.P - 9	A	Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.
N.S – 18	A	Punime topogjeodezike.

Konkretisht: Ky kriter nuk permbushet nga shoqëria “Ngracan 1934” sh.p.k anetar i bashkimit të operatoreve i cili ka marre persiper te realizojë 30% të punimeve dhe konkretisht punimet e perfshira ne **objektin 5 :Mbrojtje lumore fshati Gjonbabas .NJ.Adm Lekas** si me poshtë :

Nr An	PERSHKRIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA
I	Punime germim dhe mbushje		

3.102/b	Germim dheu me ekskavator zingjir 0.5 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, prani uji ~ 1m, kategoria IV, me shk ne toke	m3	200
3,396	Mbushje me cakull mbeturine pas gabionave	m3	300
3,331	Gabiona me rrjete teli te zinguar e gure kave 1x1x1	m3	80
3,332	Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x1.5 m	m3	110
3,334	Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x2x2 m	m3	280

Nisur nga punimet që ka marrë përsipër, shoqëria “Ngracan 1934”sh.p.k duhet të ishte e pajisur me kategorine NP 9 Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime, cka eshte ne kundërshtim me percaktimin e bere ne **nenin 88 pika 3 të VKM 285 datë 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” eshte percaktuar se** : “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, **në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**

6. Bashkimi i operatoreve “ XHENGO” shpk NIPT J64103171M, dhe “ CURRI ” shpk, NIPT J67902718S per arsye se:

1. Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7,kriteret e vecanta të kualifikimit,pika 2.2.6 ku është përcaktuar shprehimisht se:

2.2.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Lloji i Makinerive	Sasia	Pronesia
Kamion me kapacitet mbajtes deri 10 ton	Cope 3	ne pronesi ose me qera
Eskavator me zinxhir	Cope 2	ne pronesi ose me qera
Minifadrome	Cope 1	ne pronesi ose me qera
Betoniere	Cope 4	ne pronesi ose me qera

Konkretisht : në formularin permbledhes te vetëdeklarimit shoqëria Xhengo sh.p.k ka deklaruar një kamion dhe shoqëria Curri sh.p.k ka deklaruar një kamion. Pra gjithesej 2 nga 3 kamione te kerkuar ne dokumentat e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqërinë **“FLED”sh.p.k adresa: Berat Kozare HAVALEHAS Lagjja" Havaleas", rruga Ura e kozares Kuçovë, godinë private 1- katëshe, Nr.307.8,** se oferta e paraqitur me vlerë totale: **9.086.595 (nëntë milion e tetëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë)lek,pa tvsh,** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Korçë, Drejtoria e Prokurimeve, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi por jo me vone se 5 dite nga kërkesa e per lidhjen e kontrates.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe do të vijohet siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak):

PO

JO

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
SOTIRAQ FILO**